

Nga një muaj paraburgim për 15 kryekomisionerët e Malishevës



Faqe 2

KESCO kërkon rritje të çmimit të rrymës për 21.3 për qind



Faqe 4

BE-ja e shpall organizatë terroriste Gardën Revolucionare të Iranit



Faqe 6

Sllovakia s’kishte qëndrim për pranimin e Kosovës në UEFA



Faqe 17

e premte • 20 janar 2026

Numri 10258

KOHA DITORE

www.koha.net



NJOHËS TË ÇËSHTJEVE POLITIKE VLERËSOJNË SE KUSHTETUESJA KA KUFIZUAR MANOVRIMIN E DEPUTETËVE NË LIDHJE ME NËNKRYETARIN SERB TË KUVENDIT

Mosrespektimi i vendimit të Kushtetueses mund të çojë në bllokadë të re

Vendimi i Kushtetuese që e rrëzoi procedurën e zgjedhjes së Nenad Rashiqit nënkryetar të Kuvendit dhe ia njohu të drejtën e propozimit shumicës së deputetëve serbë, mund të hapë një krizë të re politike, nëse nuk zbatohet. Sipas njohësve, Kushtetuesja nuk u ka lënë deputetëve opsion tjetër pos votimit pro të nënkryetarit serb, që në këtë rast vjen si propozim nga Lista Serbe

Marigona Brahimi

PRISHTINË, 29 JANAR - Vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga komuniteti serb mund të shkaktojë krizë të re politike po qe se nuk respektohet nga deputetët, vlerësojnë njohës të çështjeve politike.

Të mërkurën, Kushtetuesja e shpalli kundërkushtetuese procedurën e zgjedhjes së Nenad Rashiqit për nënkryetar të Kuvendit dhe tha se e drejta e propozimit i takon shumicës së deputetëve të komunitetit serb.

Sipas Melos Kolshit nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, Gjykata nuk u ka dhënë deputetëve opsion tjetër pos atij për votimin e një kandidati, që në këtë rast propozohet nga Lista Serbe si partia më e madhe e serbëve në Kuvend.

“Çdo propozim i cili vjen nga ata nëntë deputetë është propozim i cili duhet përkrahur edhe nga shumica shqiptare për arsye që është jashtëzakonisht i ditur fakti që shumica shqiptare nuk mund t’ia imponojë pakicës serbe se kë e vendos për nënkryetar. Kështu që atyre u mbetet vetëm ta përkrahin”, ka thënë Kolshi.

Por në rast se shumica shqiptare nuk e mbështet sërish asnjë nga 9 kandidatët e Listës Serbe për nënkryetar dhe në rast se kjo parti si shumicë brenda komunitetit refuzon të propozojë deputetin e dhjetë serb, Nenad Rashiqin, vendi do të hyjë në bllokadë të re, ka thënë hulumtuesi

nga Instituti Demokratik i Kosovës, Vullnet Bugaqku.

“E para nuk ka konstituim të parlamentit pa e zgjedhur edhe nënkryetarin e pestë, qoftë i Listës Serbe, qoftë i komuniteteve të tjera. E dyta mund të shkojë procedura që të zvarritet edhe në atë kuptim që të shkelet afati 30- ditor i konstituimit të Kuvendit sepse mund të ndodhë që seanca të ndërpritet, të vazhdohet seancë tjetër dhe kështu të konsumohet afati 30-ditor”, ka thënë Bugaqku.

Edhe pas disa aktgjykimesh që Kushtetuesja ka nxjerrë gjatë kohës sa Kuvendi nuk ishte i konstituuar, sipas Bugaqkut, anëtarët e Gjykatës nuk i kanë sqaruar pasojat juridike të mosfunksionalizimit të tij brenda afatit 30-ditor:

“Këtu kemi një vërejtje të Gjykatës Kushtetuese, sepse edhe në këtë njoftim aktualisht që e kemi, nuk po duket që Gjykata e ka sqaruar pasojën juridike se çka ndodh nëse ky afat 30-ditor nuk respektohet dhe nuk konstituohet Kuvendi. A shkojmë në zgjedhje, a u merret mandati deputetëve apo cila është pasoja kushtetuese juridike dhe politike që mund t’u atribuohet këtyre përfaqësuesve të popullit”, ka thënë ai.

Njoftimi për vendimin me të cilin Kushtetuesja e shpalli zgjedhjen e Rashiqit antikushtetuese ishte përgjigje ndaj ankesës së Listës Serbe.

© KOHA Ditore



Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar në Kosovë njoftoi se pas heqjes së bllokadave në kufi ka nisur qarkullimi i kamionëve në drejtim të Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut më 29 janar. Transportues nga Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut, dhe Bosnja i bllokuan që nga mesdita e 26 janarit disa pika kufitare, duke ndalur qarkullimin e mallrave drejt zonës Schengen të Bashkimit Evropian. Ata kërkojnë ndryshim të rregullores që përcakton se banorët e shteteve të treta mund të qëndrojnë në zonën Schengen vetëm për 90 ditë në periudhën 180-ditore. Për ta, kjo periudhë është shumë e shkurtër dhe ua vështirëson punën. Komisioni Evropian ka premtuar gjetjen e një zgjidhjeje që do t’u lejonte transportuesve profesionistë të qëndronin më gjatë në zonën Schengen

ALGORITMET E RRJETEVE SOCIALE SHTYJNË SHUMË MË SHUMË PËRMBAJTJE DEZINFORMUESE E POLARIZUESE SESA INFORMATIVE (I)

Motorët e dezinformimit

Besnik Krasniqi

PRISHTINË, 29 JANAR – Videoja më e shikuar në rrjete sociale që përmend emrin e Fatmir Shehollit dhe që u postua ditën kur u arrestua nën dyshimin për spiunazh në favor të Serbisë, nuk e ka atë protagonist. As e dyta. Të dyja videot përmbajnë një fragment të vjetër nga polemikat për tradhti, mes politikanësh.

Në video shihet kryeministri Albin Kurti në foltoren e Kuvendit tek i drejtohet deputetit opozitar, Hisen Berisha, duke i thënë: “Unë mund t’u përgjigjem me vetëm një gjë këtyre akuzave tuaja: Ju mund ta ndihmoni shtetin e Kosovës, dhe unë kam një kërkesë për juve – mos e tako Fatmir Shehollin. Veç mos rri

me Fatmir Shehollin, bashkëpunëtorin e Serbisë. Po, te na s’ka prokurori...”.

Në momentin kur u dha deklarata, funksionoi si akuzë morale ndaj ligjvënësit që në luftën me Serbinë të rreth tri dekadave më parë, ishte një prej komandantëve të UÇK-së. Por, rishfaqja e saj në ditën e arrestimit të Shehollit e zhvendosi kuptimin duke u ricikluar si “provë” simbolike e bashkëpunimit me Serbinë dhe si konfirmim i asaj që e kishte thënë Kurti.

Kjo u reflektua në rreth 500 komente që u bënë në të dyja videot në TikTok, të cilat u shpërndanë më 9 tetor dhe kanë më shumë se 400 mijë shikime.

“Së shpejti edhe ky tjetri mas She-

hollit në flad”, shkroi njëri nga komentuesit, duke e përdorur shprehjen “flad” si simbolikë për burgun.

“Këtu nuk është vetëm Sheholli, atë e kanë ndihmuar edhe televizionet dhe gazetarët e Kosovës”, shkroi një tjetër.

Por, pati edhe të atillë, që shkruan: “Ti Albin je ma shpiun se ky”.

Në komente të tjera u përmendën emra politikanësh dhe figurash publike, që u etiketuan si bashkëpunëtorë të Serbisë ose si spiunë të rekrutuar nga shërbimi sekret serb, BIA. Shumë nga këto akuza u shoqëruan me fotografi reale ose të rreme, të gjeneruara me inteligjencë artificiale, në të cilat figura politike shfaqen pranë Shehollit ose zyrtarëve të Serbisë.

Ndryshe nga këto, raportimet neutrale për arrestimin kaluan pa vëmendje.

Artan Krasniqi, profesor i sociologjisë në Universitetin e Prishtinës (UP) që ligjëron edhe mediat, thotë se kjo nuk është rastësi.

“Informacioni neutral e i zakonshëm nuk ngjall kërshtërinë e publikut”, thotë Krasniqi. “Vetëm ajo që është sensacionale, e jashtëzakonshme, jo e natyrshme merr vëmendje”.

Tek flet mbi rastin e postimeve të fotografive me Shehollin, ai tregon se sa shpejt mund të krijohet një perceptim i gabuar publik vetëm nga dezinformatat e gjuha polarizuese në rrjete sociale.

vijon në faqen 5-6

Dështimi i trefishtë për ndërhyrje emergjente në Kalanë e Prizrenit



Ministria e Kulturës nuk është duke mundur t’ia bëjë çarenë Kalasë së Prizrenit për të zhvilluar ndërhyrjet e nevojshme. S’po gjendet kompania që për afro 85 mijë euro t’i realizojë punët e klasifikuar si “ndërhyrje emergjente”. Institucioni më i lartë kulturor në vend për herë të tretë ka hapur e mbyllur thirrje publike, por...

Faqe 12